



SMART 200 A

Llak transparent poliuretani dy komponentësh 100% me shkëlqim

Karakteristikat e produktit

- Aromë e lehtë
- Aplikim i thjeshtë
- Shkëlqim maksimal
- Transparencë e lartë
- Rezistent ndaj zverdhjes
- Karakteristika perfekte mbuluese
- Super i fortë ndaj gërvishjeve

Rekomandimet për përdorim

Rekomandohet të përdoret si llak dy komponentësh mbi sipërfaqet prej druri që janë te trajtuara paraprakisht me astar Graf 100 dhe Graf 200 të destinuara për mobilje, dyer, tavolina, karrige, objekte të ndryshme druri, tenda dielli, lodra prej druri etj.

Instruksiione aplikimi

- Përgatitja e sipërfaqes
Sipërfaqet e drurit duhet të jenë pa përmbajtje lagështie, të pastra nga pluhurat dhe pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e llakut.

Përgatitja e produktit

Përzieri dy komponentët A dhe B në raport 2A:1B me vëllim. Pas përzierjes së dy komponentëve holloni produktin me një dozë deri në 20% të vëllimit me solventin Sol DC 1 ose Sol DC 2. Nga momenti i përgatitjes së produktit, duhet aplikuar brenda 90 minutave.

Aplikimi i produktit

Aplikimi i produktit Smart 200 bëhet vetëm me pistoletë me ajër. Fillimisht pastrohet sipërfaqja e objektit nga pluhurat dhe trajtohet nga defektet dhe më pas aplikohet produkti. Pasi objekti të jetë trajtuar me dy shtresa të njëpasnjëshme astar transparent aplikohet produkti Smart 200. Pas aplikimit objekti duhet lënë për tharje në ambient të izoluar totalisht nga pluhurat dhe në temperatura të duhura. Madhësia e kokës së pistoletës së ajrit rekomandohet të jetë midis 1,4 - 2,2mm. Pastroni mjetet e punës menjëherë pas përdorimit duke përdorur pastrues me bazë solventi.

Të dhëna teknike

Rezina	Rezinë poliuretani
Densiteti EN ISO 2811-1	1,15±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	70%
Raporti i përzierjes me katalitin	1 : 1
Viskoziteti	95 ± 5 KU
Koha e reaksionit	2 – 3 orë Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur
Koha për zmerilim	24 orë
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 10
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.2

Ruajtja

36 muaj, me kusht që kanaçet të jenë të mbyllura dhe në kushte normale ruajtjeje. Ndalohet rreptësisht që produkti të ekspozohet në diell dhe lagështirë.

Shënime

- Rekomandohet që të shmangët aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C dhe mbi 30°C.

